

Taksa e pullës
u likuidua

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA NOTERIALE E TIRANES

NOTER LAURA JUSTINA

NR. REP. 263

NR. KOL 43

Sot, më datë 29 Janar 2020 (dymijë e njëzet), para meje Noterit, anëtar i Dhomës së Noterisë Tiranë, ditën e Mërkurë, ora 19.00 në zyrën time noteriale është paraqitur personalisht Z. Gerond Meçe, i biri i Agronit dhe i Shegushes, i lindur më datë 30.08.1972, në Elbasan, dhe banues në Tiranë, Rr. Durrësit, Kompleksi “Karavan”, Ap. 64, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit ne Nr. 030094626.

Personat e mësipërm, për identitetin e dhe cilësitë e të cilëve unë noteri jam i sigurtë më kërkuar përpilimin dhe noterizimin e aktit “Akt i themelimit” të shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar në krijim e sipër “Artificial Intelligence Business Solutions” shpk.

Për sa më sipër, unë noteri kam komunikuar personalisht me personin e mësipërm, i jam përgjigjur të gjitha pyetjeve dhe kam marrë deklaratat e tij dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi kam përpiluar aktin ligjor me përmbajtjen si më poshtë vijon:



AKT I THEMELIMIT

të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar

"Artificial Intelligence Business Solutions"

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Sot më datën 29.01.2020, mbështetur në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar dhe në Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar dhe në Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë, themelohet nga ortakët me vullnetin e tyre të lirë, të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi, shoqëria "**Artificial Intelligence Business Solutions**" shpk me këta ortakë:

1. **Gerond Meçe**, i biri i Agronit dhe i Shegushes, i datëlindjes 30.08.1972, lindur në Elbasan, banues në Tiranë, Rr. Durrësit, Kompleksi "Karavan", Ap. 64, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit ne Nr. 030094626.

EMËRTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE, KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 2

Emërtimi i Shoqërisë dhe emri tregtar

2.1 Emërtimi i shoqërisë do të jetë :

Artificial Intelligence Business Solutions


2.2 Emërtimi tregtar i shoqërisë do të jetë :

AiBS

Neni 3

Forma ligjore

- 3.1 Ortakët themelojnë këtë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin tregtar në fuqi të Republikës së Shqipërisë.
- 3.2 Shoqëria konform Ligjit "Për Shoqëritë Tregtare" në fuqi dhe dispozitave përkatëse të këtij statuti, mund të shndërrohet me një vendim të posaçëm në një shoqëri me një formë tjetër.





Neni 4

Kohëzgjatja e veprimtarisë

4.1 Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë e pakufizuar.

4.2 Shoqëria "Artificial Intelligence Business Solutions" është person juridik. Ajo fiton të drejtën e personit juridik nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Neni 5

Selia e shoqërisë

5.1 Selia e shoqërisë do të jetë në adresën:


Njesia bashkiake nr. 2
Rr. "Papa Gjon Pali II"
Pall 11/1, Hyrja 1, Ap 19.
Tiranë, Shqipëri.

5.2 Shoqëria mund të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 6

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë

6.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- **Dizenjim softuer.** Këtu përfshihet analiza e kërkesave të sistemit softuer, projektimi i arkitekturës dhe projektimi i detajuar i sistemit softuer;
 - **Zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh software.** Këtu përfshihet programimi i sistemeve softuer, kodimi, instalimi, integrimi i të gjithë komponentëve, dokumentimi, identifikimi dhe korrigjimi i gabimeve, modifikimet, mirëmbajtja e të gjithë komponentëve, suporti i sistemit si një tërësi komponentësh, që, në funksionimin e tyre, realizojnë qëllimin e zgjidhjes informatike;
 - **Testim softuerësh.**
 - **Dizenjim dhe zhvillim sistemesh të komunikimit.** Këtu përfshihet analiza, planifikimi, projektimi, zbatimi, vendosja në punë dhe mirëmbajtja e sistemeve të komunikimit të rrjeteve të pajisjeve informatike (LAN/ WAN/ WLAN/ MAN/ SAN/ CAN);
 - **Disenjim dhe zhvillim sistemesh të sigurisë.** Këtu përfshihet analiza e kërkesave të sigurisë së klientit, projektimi i arkitekturës, instalimet dhe konfigurimet e komponentëve, vendosja në punë, testimet e sigurisë dhe mirëmbajtja përkatëse;
 - **Zhvillim sistemesh migrimi.** Këtu përfshihet transferimi i të dhënave dhe infrastrukturës përkatëse nga një teknologji e vjetër në një teknologji të re;
 - **Përmirësim/upgrade sistemesh informatike;**
- 

- o **Operimi, menaxhimi, suporti i përdorimit, trajnimi dhe auditimi teknik/informatik për sistemet softuer.**

6.2 Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet, shtohet ose pakësohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme në bazë të Nenit 81, të Ligjit 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Neni 7

Kapitali Themeltar

7.1 Kapitali themeltar i shoqërisë "Artificial Intelligence Business Solutions", përbëhet në të holla në një vlerë prej 100 (një qind) lekë.

Kapitali i Shoqërisë do të ndahet në 1 kuotë (pjesë) të barabartë me 100 lekë, korresponduese me 100% të kapitalit të shoqërisë.

7.3 Kapitali themeltar dhe lëvizjet e tij do të mbahen në një regjistër të veçantë.

ORGANET E SHOQËRISË

Neni 8

Asambleja e Përgjithshme

8.1 Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime vetëm në rastet kur sigurohet kuorumi i duhur i ortakëve të shoqërisë ose të përfaqësuesve të tyre.

8.2 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme do të merren nëse marrin pjesë në të ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave.

8.3 Në rastet kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë pjesëmarrës në këtë Mbledhje.

8.4 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të mblidhet me një shumicë të cilësuar 75,00% të votave dhe do të thirret nga Administratori i Shoqërisë në këto raste:

- o Lidhjen e kontratave me ortakët dhe/ose filialet e tyre.
- o Miratimin e pranimit ose largimit të ortakëve në shoqëri.
- o Miraton bilancin vjetor të shoqërisë.
- o Vendos për shtimin, pakësimin ose transferimin e kapitalit themelor.
- o Emëron dhe shkarkon administratorin e Shoqërisë
- o Vendos për mbylljen e aktivitetit të shoqërisë ose shndërrimin e shoqërisë.

Neni 9

Administratori / Administratorët

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë administratorë të shoqërisë.
- 9.2 Afati i emërimit nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje.
- 9.3 Administratori i shoqërisë emërohet Z. Gerond Meçe, i lindur më datë 30.08.1972, në Elbasan, dhe banues në Tiranë, Rr. Durrësit, Kompleksi "Karavan", Ap. 64, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit ne Nr. 030094626.
Emërimi i tij do të prodhojë efekte pas regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 9.4 Administratori i shoqërisë ka të gjitha kompetencat për të vepruar në emër dhe për llogari të shoqërisë në marrëdhënie me të tretët.
- 9.5 Administratori nuk mund të kryejë vetëm ato detyra që i janë lënë për kompetencë Asamblesë së Përgjithshme.
- 9.6 Shoqëria merr përsipër të gjitha pasojat që mund të vijnë nga veprimet e administratorit.
- 9.7 Administratorët janë përgjegjës individualisht ose solidarisht ndaj shoqërisë ose ndaj personave të tjerë, kur gjatë veprimeve të tyre shkelin ligjin ose statutin.

Neni 10

Mosmarrëveshjet

- 10.1 Nëse shoqëria do të ketë gjatë aktivitetit të saj më shumë se një ortak, çdo mosmarrëveshje mes ortakëve të shoqërisë do të zgjidhet me mirëkuptim mes tyre, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e çdo konflikti mes tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 11

- 11.1 Ky Statut hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe me fuqi të barabartë ligjore dhe pasi gjindet i hartuar sipas vullnetit të lirë e të plotë të palëve, nënshkruhet prej tyre rregullisht.

ORTAKU I VETEM I SHOQËRISË:

Gerond Meçe





Për efektet e ligjit, unë noteri, përpiloj këtë Akt themelimi, në katër kopje me të njëjtën vlerë ligjore, në gjuhën shqipe. Akti u lexohet me zë të lartë personave të paraqitur dhe pasi gjendet sipas vullnetit të tyre të plotë dhe të lirë, nënshkruhet rregullisht prej tyre nga palët në praninë time. Unë noteri, vërtetoj ligjshmërinë e këtij akti dhe nënshkrimet e tyre sipas ligjit. Nr. 110/2018 datë 20.12.2018 “Për Noterinë”

NOTERE

Laura Pustina

